




KONFIRMIM DEPOZITIMI DOKUMENTACIONI NË GJYKATË KUSHTETUESE

Në datë 24.04.2024, ora 12:35 u depozitua në Gjykatën Kushtetuese dokumentacioni me dërgues 1110 e Deputetëve të Kuvendit Shqipërisë dhe objekt: lëndë: Kundërshtim i vendimit nr. 41/2024 dt. 11.04.2024 të Kuvendit ... "Përmirësimi e Mocionit në Gj. Kushtetuese" etj

Specialiste e protokoll-arkivit në Gjykatën Kushtetuese

Alketa Spahiu

Nënshkrimi (vu)



Kushtetuese" dhe deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të këtij vendimi.

2. Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve, duke përcaktuar mënyrën kushtetuese konkrete sesi zgjidhet ky konflikt dhe sesi ushtrohet e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare (një të dhjetës së deputetëve) për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale, në kushtet ku mazhoranca me votim ka vendosur moszbatimin e vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese dhe kjo mund të ripërsëritet në të ardhmen.

3. Interpretimin përfundimtar të neneve 70, pika 1 dhe 4; 73, pika 1; dhe 132, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4. Shqyrtimin me përparësi të kësaj çështje, për shkak se paraqet një interes të lartë publik.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4, 7, 70, 71, 73, 124, 131, gërma "ç", 132, dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 23 Prill 2024

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

JO MË PAK SE 1/10 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË dhe JO MË PAK SE 1/5 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, me adresë njoftimi: “Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike”, Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Grupit Parlamentar z. Gazment Bardhi dhe Av. Marash Logu, ose persona të tjerë të caktuar prej tyre.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, me adresë njoftimi: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Kundërshtimi i vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosdërgimin e Mocionit në Gjykatën Kushtetuese” dhe deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të këtij vendimi.

2. Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve, duke përcaktuar mënyrën kushtetuese konkrete sesi zgjidhet ky konflikt dhe sesi ushtrohet e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare (një të dhjetës së deputetëve) për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale, në kushtet ku mazhoranca me votim ka vendosur moszbatimin e vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës Kushtetuese dhe kjo mund të ripërsëritet në të ardhmen.

3. Interpretimin përfundimtar të neneve 70, pika 1 dhe 4; 73, pika 1; dhe 132, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4. Shqyrtimin me përparësi të kësaj çështje, për shkak se paraqet një interes të lartë publik.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4, 7, 70, 71, 73, 124, 131, gërma “ç”, 132, dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë;

Nenet 27, 49, 50, 51 dhe 66 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

DREJTUAR:

GJYKATËS KUSHTETUESE

***E nderuar Znj. Kryetare e Gjykatës Kushtetuese,
Të nderuar Gjyqtarë Kushtetutes,***

Shqipëria menjëherë pas miratimit të Reformës në Drejtësi justifikoi mungesën e një Gjykate Kushtetuese funksionale prej rreth 3 vitesh, me faktin se kjo ishte një kosto e arsyeshme që duhej pranuar për shkak të nevojës që vendi ynë kishte për një Gjykatë Kushtetuese profesionale, me integritet dhe të paanshme. Reformimi i Gjykatës Kushtetuese ishte pjesë thelbësore e Reformës në Drejtësi dhe një garanci e mëtejshme për një sistem drejtësie sipas standarteve europiane.

Në cdo vend demokratik zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm dhe themeli mbi të cilin ngrihet një shtet ligjor. As Kuvendi dhe asnjë institucion publik nuk mund të shpall “sovrانيتin” përkundëjt vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sepse kjo do të rrëronte parimin kushtetutes “të balancës dhe kontrollit mes pushteteve”, duke vënë në pikëpyetje vetë ekzistencën e shtetit demokratik, sepse do të merrte tiparet e qarta të një puci kushtetutes institucional.

Në vijim të një ankimi të deputetëve të opozitës, me vendimin nr. 1/2023 Gjykata Kushtetutese ka zgjidhur konfliktin e kompetencave dhe qartësisht ka kërkuar nga Kuvendi që të përcjell për shqyrtim pretendimin për papajtueshmëri të mandatit të deputetes së PS Olta Xhacca, për shkak se ajo dhe bashkëshorti i saj kanë përfituar të drejtën për të përdorur pasuri publike përmes njohjes nga Qeveria të statusit të investitorit strategjik. Konkretisht, me vendimin **nr. 1, datë 23.1.2023¹**, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka vendosur: “... *vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënie në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë që pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla.....Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetutese vlerëson se në rastin konkret Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuarit dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në këtë Gjykatë, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes Olta Xhacca t’i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi.*”.

Për 1 vit e 3 muaj mazhoranca refuzonte në mënyrë të përsëritur zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke mos e përfshirë në rend dite të seancës plenare. Pas këmbënguljes së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, mazhoranca vendosi të përfshijë për shqyrtim zbatimin e këtij

¹ vend.01_23 (1).pdf

azment Berolhi ~~Berolhi~~
lefter Geshutenge ~~to stey~~
Fandant anty' ~~at~~

4. Tiba Dioni ~~DS.~~
5. Lheri Gjergj' ~~Gr.~~
6. Lindita Metkalinj ~~Dr.~~
7. Emilje Voliqi ~~Ed. Voliqi~~
8. Ajron Gjemokaj ~~Dr.~~
9. Luf Kolaj ~~Dr.~~
10. EDI PALOKA ~~Dr.~~
11. Blazna Velbafi ~~Dr.~~
12. Kamelun Vukaj ~~Dr.~~
13. Stjepan Nohaj ~~Dr.~~
14. Albana Volshe ~~Dr.~~
15. Tuta Shk ~~Dr.~~
16. Xhela Mzei ~~Dr.~~
17. Leam Baq ~~Dr.~~
18. Jadona Hoxha ~~Dr.~~
19. Bujar Lesnjaj ~~Dr.~~
20. QANI XHATA ~~Dr.~~
21. Greta Boreli ~~Dr.~~
22. Oda Holi ~~Dr.~~

Saimur Kavelu

24. Jemel Sylyhbohul

25. Asken Dappani

26. Ensim Salioni

27. Ina Zhupa

28. Samuel Spata Enatas

29. Kastriot Gironi

30. Jule Tobelu

31. Petut Doda

32. Dunte Cusi

33. Oriela Pebijei

34. Placem Asle

35. Trada Bano

36. Petut Vanili

37. ERISA XHIXHO

38. Monika Jayemoolki

39. Helena Bedeti

40. Veshonv' Hielu

41. ANON SHEHTA

42. Kasem Mahumata

43. Vanyet Jule

originalet e Koto *[Signature]*

[Shqiptaria.com]